



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.413/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) sh.a me seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Clinton nr.5, kundër debitorit NTSH Blodi – I.S. B.I. me seli në Prizren rr. 11 ...– Kumanova p.n., duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.918/2020 të datës 14.12.2021, me datën 06.07.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit NTSH Blodi – I.S. B.I. me seli në Prizren, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.918/2020 i datës 14.12.2021, VËRTETOHET

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.918/2020 të datës 14.12.2021, e ka Refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit NTSH Blodi – I.S. B.I. me seli në Prizren, i ushtruar kundër urdhrit për përmbartim P.nr.821/2020 të datës 05.11.2020, i lëshuar nga përmbartuesi privat Rushit Hoxha nga Prizreni, dhe e ka lënë në fuqi urdhërin përmbartimor P.nr.821/2020 të datës 05.11.2020, i lëshuar nga përmbartuesi privat Rushit Hoxha nga Prizreni

Debitori kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës përmbartimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovoj si të bazuar ankesën e debitorit, të Ndryshohet Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.918/2020 të datës 14.12.2021, dhe Aprovohet prapsimi i debitorit si i bazuar dhe anulohet urdhri përmbartimor 821/20 dt.05.11.2020, ose të anulohet aktvendimi i atakuar dhe lënda të ktheheht ne rivendosje.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 05.11.2020, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm-Ekstraktit nga librat afariste. Përmbartuesi privat Rushit Hoxha nga Prizreni, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.821/20 të datës 05.11.2020, ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit DPZ-....., për pagesat në emër të shërbimit të furnizimit me energji eketrike, shumën prej 1,592.08€, si dhe shpenzimet e caktuara të përmbartimit në shumën prej 47.20€.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka ushtruar prapësim me datën 12.11.2020 duke pretenduar se e ka lëshuar lokalin në rrugën xhemë Gostivari 101 prizren, dhe nuk ka zhvilluar biznes pranë këtij lokali në rrugën Ismet Jashari, i propozon gjykatës që ta shfuqizoj urdhrin përmbartimor dhe të anulohen të gjitha veprimet përmbartimore.

Përgjigje në prapësimin e debitorit ka paraqitur kreditori me datën 03.12.2020, me arsyetimin se prapësimi i debitorit në tërësi është i paabzuar, i paarqitur me qëllim të zvarritjes dhe prolongimit të procedurës përmbartimore.

Gjykata Themelore në Prizren, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.918/2020 të datës 14.12.2021, me të cilin e ka Refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetimin të aktvendimit, Gjykata e shkallës së parë ka cekur se propozimi për përmbartim është bërë në bazë të dokumentit të besueshëm të përmbartimit – ekstraktit nga librat afariste, nga neni 29 par.1 pika 1.2 dhe neni 30 dhe 37 të LPP-së. Debitori nuk ka ofruar ndonjë provë konkrete me të cilën vërtetohet se është përmbushur detyrimi. Nga shkresat e lëndës e sidonos nga kartela financiare rezulton se borxhi evidentohet në emër të debitorit dhe gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur ndërrim të shfrytëzuesit dhe as kërkese për ndërrim. Prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 3,5,13,21,29,37,40,69,71,73 dhe 77 dhe 78 të LPP-së.

Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhomat e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja

faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale të Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbaremore, kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër Urdhrit të Përmbaresit Privat më të cilin është lejuar përmbarimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të Ekstraktit nga librat afariste kartelës së klientit DPZ-....., e lëshuar nga kreditori, në vlerë prej 1,592.08€, i cili në bazë të nenit 29 paragrafi 1 pika 1.2 e LPP-së, ka cilësinë e dokumentit të besueshëm dhe se i njëjti si i tillë paraqet bazë juridike, për lejimin e përmbarimit, ashtu siç përcaktohet me nenin 21 të të njëjtit ligj.

Dhomat e shkallës së dytë, nuk mund ti pranoi si të bazuara pretendimet ankimore të debitorit të paraqitura në ankesë lidhur me ndryshimin e adresës së operimit si biznes, sepse i njëjti ka pasur obligim ti parashtrij me kohë te kreditori këto pretendime, me qëllim, të ndryshimit eventual të borxhit. Andaj vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë, kjo Gjykatë e sheh si të drejtë dhe të ligjshëm. Nga të cekurat më lartë kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit si e pathemeltë.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II nr.413/23 me datë 06.07.2023

Gjyqtari  
Krenar Berisha